



ORGANIZATA PËR DEMOKRACI, ANTIKORRUPSION
DHE DINJITET – ÇOHU!

DËMTIMI I SEKTORIT PUBLIK NGA KORRUPTIMI I POLITIKËS

RAST STUDIMI:

TREGU I TELEKOMUNIKACIONIT

ANALIZË # 2

QERSHOR 2008

Rruga, "Ahmet Krasniqi", Nr. 5,
Arbëri Prishtinë
organizatacohu@yahoo.com

WWW.COHU.ORG

038 248 506

Përmbledhje

Ky rishikim i shkurtër i zhvillimeve të viteve të fundit në tregun e telefonisë mobile ka për qëllim të tregojë ndikimin që është vendosur mbi politikën nga ana e bizneseve që veprojnë në tregun e telekomunikacionit dhe të shërbimeve të internetit dhe pasojat që kjo ka pasur për kompaninë publike në këtë fushë. Ndikimet nga sektori privat në kompaninë e vetme publike që ofron shërbime të telefonisë mobile dhe internet, PTK, janë shtrirë në forma të ndryshme. Ky ndikim është bërë duke filluar nga korruptimi i partive politike deri tek politizimi dhe futja e konfliktit të interesit në bordet e kompanive publike dhe të AKM-së. Fakti që përbërja e njëjtë në ART, e cila e pat dështuar njëherë tenderin për operatorin e dytë të telefonisë mobile për shkak të korrupsionit, vazhdon të sjellë vendime të rëndësishme për këtë treg madje përkundër faktit se në asnjë moment nuk është kompletuar Bordi i ART-së dhe fakti se politika ndihet krejtësisht e pafuqishme për ta vendosur këtë agjension brenda ligjit, është indikator i qartë i korrupsionit të palëve më të rëndësishme në politikë. Në anën tjetër ndikimi i konkurrentit të kompanisë publike në shërbime të telefonisë mobile dhe internet është institucionalizuar me emrimin e një aksionari të Ipkos në Bordin e AKM-së, bord i cili menaxhon kompaninë publike PTK/Vala. Tutje, transferi i thjeshtë i zyrtarëve të lartë të PTK-së tek Ipko përveç që ka cënuar sekretin komercial të kompanisë publike dhe erozion të burimeve njerëzore në të cilat PTK ka investuar shumë, është kthyer me mbropa me ndikime tek pjesa e mbetur e menaxhmentit të Valës. Rasti që ilustron më së miri këtë ndikim është shtyerja e implementimit dhe bërjes publike të lirimtarisë të Valas derisa Ipko organizoi një fushatë agresive marketingu për lirimtarisë duke marrë kështu ekskluzivitetin në këtë aspekt.

Sfondi historik i tregut të telekomunikacionit

Tregu i telekomunikacionit në Kosovë nga aspekti i menaxhimit të frekuencave rregullohet nga Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit (ART). Momentalisht dy kompanitë më të rëndësishme në këtë treg janë operatori publik Vala 900 (Vala) dhe operatori tjetër jopublik IPKO Telecommunications (Ipko). ART funksionon në bazë të Rregullores 2003/16 për Themelimin e ART-së dhe në bazë të Ligjit për Telekomunikim, të cilat përcaktojnë parimet elementare të udhëheqjes së kësaj fushe. Një nga parimet qenësore të funksionimit të një agjensionit të pavarur, të sanksionuara edhe në rregulloren/ligjin e lartpërmendur është konstituimi i bordit të drejtorëve, të cilët si kusht elementar duhet të jenë të pavarur nga ndikimi i jashtëm politik, industrial apo çfarëdo influence tjetër.

Të dy këta elementë janë shkelur vazhdimisht në ART-në kosovare. ART-ja sot e kësaj dite mund të konsiderohet ilegal duke qenë se Bordi i saj nuk është konstituuar si i kompletuar në asnjë moment. Kryetari i Bordit të ART-së, Anton Berisha, gjithmonë ka funksionuar si titullar i këtij institucioni duke mos konstituuar në asnjë moment Bordin. Përveç afrimit të tij të madh me njërin nga biznesmenët e involvuar në tregun e telefonisë mobile, zotin Ekrem Lluka, shkelja tjetër e rëndë e bërë nga Berisha është angazhimi direkt politik me kandidimin e tij për deputet në kuadër të LDK-së. Pra, kryetari i Bordit inekzistent të ART-së ka thyer Rregulloren për themelimin e ART-së dhe Ligjin për shërbyes civil duke qenë se është vënë në ndikim direkt politik dhe industrial. Këto të dyja e bënë atë në vazhdimësi të shkatërrojë konkurrencën e lirë në këtë sektor.

Edhe pse i pakompletuar, Bordi i ART-së ka marrë vendime të rëndësishme. ART, gjegjësisht disa persona që janë thirrur në emër të këtij autoriteti të pavarur, kanë organizuar një tender për dhënie të licensës për operatorin e dytë të telefonisë mobile në vitin 2004, tender i cili është anuluar për shkak të dyshimeve për korrupsion. Në këtë tender, përkundër faktit se ishin të interesuara kompani ndërkombëtare shumë serioze, ART pat vendosur që licensën për operatorin e dytë t'ia japë një konzorciumi që në masën më të madhe përfaqësohej nga biznesmeni Ekrem Lluka dhe nga Mobilkomi slloven. Ky tender që anuluar nga autoritetet kosovare dhe ndërkombëtare për shkak të dyshimeve për korrupsion. Tri vjet më vonë, të njëjtit njerëz që njëherë kishin dështuar tërë procesin për shkak të korrupsionit, riorganizojnë tenderin për operatorin e dytë të telefonisë mobile duke nxjerrë fitues sërish esencialisht të njëjtit njerëz dhe të njëjtat kompani. Në pranverën e vitit 2007, ART-ja sërish nxori fitues Ekrem Lluken në një proces krejtësisht jotransparent. Konzorciumi Kosmocell i përfaqëuar nga kompanitë Dukagjini dhe Kujtesa, është shpallur fitues i këtij tenderi pasi ka ofruar 81 milionë euro për t'u tërhequr vetëm pak kohë pas shpalljes si fitues dhe për t'ia lëshuar rrugën konzorciumit tjetër i përbërë nga partneri i zotit Lluka, Mobilkomi slloven, kompani kjo e cila kishte fituar licensën në tenderin e bërë para tri vitesh por që që anuluar për shkak të dyshimeve për shkelje. Tri vjet më parë ishte pikërisht Ipko kompania e cila kishte kundërshtuar shpalljen fitues të Mobilkomit slloven duke përdorur ndikimin e vet politik dhe ky i fundit që në ndërkohë e bleu kundërshtarin e vet, kryesor, Ipkon, për të vendosur një ndikim definitiv mbi politikën kosovare.

Në këtë mënyrë në pranverën e vitit 2007, fitues shpallet ofertuesi i dytë, Mobilkomi Slloven i përfaqësuar nga IPKO, i cili mori licensën edhe pse ofertën e kishte më të vogël për plot 7 milionë euro nga konzorciumi i përfaqësuar nga Dukagjini. Më vonë del se në të vërtetë zoti Lluka ka qenë pjesëmarrës në të dy konzorciumet që u renditen të parat në këtë tender, atë të Dukagjinit dhe atë të Ipko/Mobilkomit slloven. Njëanshmëria e ART-së, gjegjësisht zotit Berisha, duket edhe njëherë kur, përkundër faktit se në mënyrë të qartë është përcaktuar në Paketën tenderuese se në rast tërheqjeje entitetit fitues i ndalet garancioni prej 20% nga çmimi i ofruar, kjo nuk ndodhi në asnjë moment duke dëmtuar në këtë mënyrë Buxhetin e Kosovës për 16,2 milionë euro.

Esencialisht tenderi për operatorin e dytë, organizuar për herë të dytë nga ART më 2007, ka qenë shumëherë më i korruptuar sesa ai i bërë tri vite më parë i anuluar për dyshime për korrupsion. Në këtë rast ART nuk ka bërë hapjen e ofertave në mënyrë publike, ashtu siç kërkon Ligji për prokurim dhe Ligji mbi telekomunikacionin dhe siç kërkojnë rregullat e BE-së për lojalitet në konkurrencë. Me lejimin e Mobilkomit slloven që të jetë pjesë e dy konzorciumeve, atë me IPKO Telecommunications dhe me konzorciumin Kosmocell dhe në anën tjetër me lejimin e zotit Lluka që të jetë pjesë e konzorciumit të përfaqësuar nga Dukagjini dhe Kujtesa dhe atij me Ipko, ART ka lejuar një entitet biznesi të bëjë më shumë se një ofertë, të ndaluar në mënyrë eksplicite me Paketën tenderuese. Tutje, kriteret dhe nënkriteret, në mospajtim me ligjin, nuk janë botuar nga ART deri në momentin e mbylljes së ofertimit nga kompanitë publike duke mundësuar kështu diskriminim në konkurrencë duke qenë se këto informacione duket qartë se i kanë pasur entitetet e biznesit të afërta me shefin e ART-së, Anton Berishën, të cilat kanë dalur fitues

në të gjitha herat e organizimit të tenderit për operatorin e dytë të telefonisë mobile. Mbi të gjitha, lidhjet e ART-së me Mobilkom in slovene dhe me zotin Lluka u panë kur nuk u mor 20% e ofertes që do duhej të ishte e dorëzuar si garancion dhe në këtë formë u dëmtua Buxheti i Kosovës për 16,2 milionë euro.

Mbi të gjitha këto shkelje, kompani të njohura ndërkombtarisht në tregun ndërkombëtar të telefonisë mobile kanë bërë ankesa. Vodaphone ka dërguar ankesa në ART dhe institucionet e Kosovës, kurse Telekom Austria ka dërguar një ankesë në Dhomën e Veçant të Gjykatës Supreme. Të gjitha këto janë injoruar nga institucionet kosovare. Përkundër faktit se është e qartë se lojaliteti i ART-së tashmë është blerë nga bizneset slovene pjestar të operatorit të dytë të telefonisë mobile dhe nga zoti Lluka, Kosova sot e kësaj dite ka të njëjtit njerëz që i prijnë autoritetit rregullativ të sektorit më me interes për shtetin dhe politika nuk është në gjendje të veprojë për ta mbrojtur interesin e qytetarëve të Kosovës.

Sfondi politik dhe spekulimet

Si është e mundur që ART, gjegjësisht disa njerëz që sjellin vendime në emër të këtij autoriteti, të bëjë të gjitha këto shkelje dhe askush të mos ndër marrë asgjë? Arsyetimi i parë që del nga spekulimet në lidhje me këtë proces është se përfaqësuesit e entiteteve që në vazhdimësi janë shpërblyer me licensë nga ART kanë shpërndarë mes tre e gjashtë milionë euro tek palët më të rëndësishme në politikë. Sipas këtyre spekulimeve këta miliona euro janë shpërndarë tek partitë politike dhe liderët që ishin në pushtet në atë kohë, AAK e LDK, si dhe tek partia më e madhe opozitare, PDK, por edhe tek përfaqësuesit e UNMIK-ut në komisionet vlerësuese në tenderin për operatorin e dytë të telefonisë mobile, në të dy herat e organizimit të këtij tenderi nga ART.

Si parti opozitare, PDK pat bërë një përpjekje për të adresuar problemin e ART-së në Kuvendin e Kosovës për t'u disiplinuar në tërësi në verën e vitit 2007, kur PDK pothuaj se nuk u dëgjua më, me gjithë faktografimin e shkeljeve të ART-së të bëra publike nga mediat dhe nga Organizata ÇOHU!. Diçka më shumë se një vit i tërë ky disiplinim i PDK-së del në shesh kur Qeveria e prirë nga po kjo parti vendos anëtar Bordi të AKM-së njërin nga aksionarët e Ipkos duke shkaktuar një konflikt të qartë interesi.

As sot e kësaj dite nuk është adresuar situata në ART edhe përkundër faktit se Bordi nuk është kompletuar asnjëherë dhe shefi i Bordit, Anton Berisha, pothuaj se nuk shkon në zyre përveç kur ka për të nënshkruar ndonjë marrëveshje në favor të operatorit privat të telefonisë mobile, siç ishte Marrëveshja për interkoneksionin, e cila ka arbitruar çmime që diskriminojnë operatorin publik. Në anën tjetër asnjë nga partitë politike në opozitë nuk janë duke ngritur zërin për një shkatërrim të qartë të konkurrencës në treg nga ana e autoriteteve kosovare në fushën e telekomunikimit. Ky argument tregon më së miri se si e tërë politika është vënë në një situatë kur është e pamundur ndërmarrja e ndonjë veprimi për të vendosur ligj në këtë sektor. Në një moment ose në një tjetër të gjitha partitë kryesore politike kosovare janë disiplinuar përsa i përket këtij sektori dhe sot e kësaj dite nuk mund të pritët ndonjë veprim nga to për të vendosur rend në fushën e telekomunikimit.

Konflikti i pastër i interesit

Operatori privat në telefoninë mobile siç po shihet ka vendosur një ndikim determinues në politikë. Ky ndikim u kurorëzua me nominimin e Dino Asanajt në Bordin e AKM-së nga ana e Qeverisë së Kosovës. Asanaj është emëruar anëtar i Bordit të AKM-së përkundër faktit që ka qenë publikisht i njohur si pronar aksionesh në Ipko si operator privat. Mundësia e tij që të sjellë vendime në lidhje me PTK-në/Valën dhe njëkohësisht të ketë interes privat në kompaninë konkurruese të Valës është një konflikt interesi.

Organizata ÇOHU! ka alarmuar institucionet e Kosovës dhe UNMIK-un për këtë konflikt interesi, por Qeveria e Kosovës, UNMIK-u po edhe opozita kanë qenë në një situatë kur praktikisht nuk kanë pasur fuqi të veprojnë kundër një qendre interesi që me kohë kishte vendosur ndikimin e vet mbi politikën. Kjo në praktikën politike quhet dominim i interesit special, por që në këtë rast fatkeqësisht shkon në dëm të madh të pasurisë publike kosovare. Fakti që kjo Qeveri ka interesa krejtësisht jotransparente të lidhura me pjestarë të aksioneve të operatorit të dytë të telefonisë mobile u pa edhe më qartë kur, përkundër faktit se publiku kosovar praktikisht nuk e njef fare zotin Asanaj, Qeveria e emroi atë anëtar në një organ tjetër esencial për të ardhmën e ekonomisë kosovare, atë të Komitetit drejtues për termocentralin Kosova C.

Që nga themelimi i kësaj Qeverie në janar 2008 dhe më vonë emërimi i Asanajt anëtar Bordi në AKM, në një masë të konsiderueshme është ngrirë zhvillimi i operatorit publik të telefonisë mobile. Pa një drejtor menaxhues, pa një Bord udhëheqës dhe pa një autoritet rregullativ funksional, kompania publike që ofron shërbime të telefonisë mobile dhe të internetit pothuajse nuk ka ndonjë zhvillim esencial. Tarifat kanë ngelur të larta, shërbimet më të kufizuara edhe në llojllojshmëri edhe në kualitet. Menaxhmenti është larguar në vazhdimësi nga operatorit publik, në ndërkohë që jo rrallë njerëzit e ikur nga PTK “befasisht” kanë gjetur punë në operatorin privat të telefonisë mobile dhe të internetit, në konkurrentin e PTK-së. Përballë një agësiviteti të jashtëzakonshëm të marketingut të bërë nga ana e Ipko, PTK pothuaj se ka marrë një profil submisiv në treg dhe as që jep shenja se do të shfrytëzojë përparësitë krahasuese për të mbajtur tregun.

Pasojat në pronën publike – rasti i PTK-së

Në kohën e dhënies së licensës për operatorin e dytë të telefonisë mobile, operatorit publik Vala 900 është llogaritur të ketë një vlerë mes 800 milione e 1 miliardë euro. Për shkak të monopolit të mbajtur për një kohë të gjatë Vala 900 u bë kompania më profitabile dhe më e madhja në Kosovë dhe në këtë mënyrë u bë kompania e vetme me kontributin më të madh për Buxhetin e Kosovës.

Që nga koha kur ka filluar punën operatorit i dytë i telefonisë mobile kjo situatë ka ndryshuar shumë. Me fillimin e punës së operatorit të dytë, ART, e udhëhequr nga njeriu që ishte lojtar në treg i bizneseve që themeluan këtë konzorcium, Anton Berisha, bëri marrëveshjen për interkoneksion që favorizon operatorin privat Ipko Telecommunication përballë atij publik, Vala 900. Kjo ishte një shkelje serioze e tregut të lirë dhe një deformim i konkurrencës. Qeveria nuk ndërmori asnjë hap për ta mbrojtur pronën publike në këtë rast, por as opozita nuk u dëgjua fare. Në anën tjetër, Qeveria e Kosovës, gjegjësisht ministri i Transporteve dhe Telekomunikacionit, Fatmir Limaj, në të njëjtën

kohë nxorën idenë e privatizimit të Valës dhe njëkohësisht nominuan një pronar të aksioneve në operatorin privat Ipko, si anëtar të Bordit të AKM-së i cili mes tjerash do të ketë përgjegjësi edhe për politikën zhvilluese të operatorit publik Vala duke shkaktuar kështu një konflikt të pastër interesi.

Politikat e qeverisë së kaluar dhe kësaj aktuale të udhëhequr nga kryeministri Thaçi në raport me PTK-në dhe Valën kryesisht kanë qenë të dëmshme. Me të marrë postin qeveria aktuale filloi të bëjë presione të mëdha dhe kërcënime për të gjitha kompanitë publike dhe sidomos për PTK-në për reduktimin e pagave, duke demotivuar një numër të konsiderueshëm të menaxhmentit të kompanisë publike. Një numër i menaxherëve të PTK-së dhe Valës tashmë kanë kaluar me punë në operatorin privat të telefonisë mobile ose kanë lëshuar punën në PTK si pasojë e pasigurisë së krijuar nga Qeveria Thaçi, gjegjësisht ministri Limaj. Ky ishte vetëm fillimi i shënimit të një erozioni të aseteve të PTK-së/Valës, si kompania më e madhe publike, dëmtim i cili është duke vazhduar edhe sot e kësaj dite.

Momentalisht, tregu është duke rrëshqitur me një shpejtësi marramendëse nga duart e operatorit publik Vala, duke qenë se ky sektor është ngrirë në tërësi për shkak të politikave qëllimisht të gabueshme të Qeverisë Thaçi. Sot PTK-ja jo vetëm që është e mbyllur në një rreth të komplikuar prokurimi, me rrezikshmëri të lartë për bartjen e pasojave tek menaxhmenti për vendimet me risk, por është duke funksionuar pa drejtor menaxhues dhe pa Bordin udhëheqës.

Që prej se në Bordin e AKM-së është futur një pronar aksionesh në operatorin privat të telefonisë mobile ka pasur një abstenim total të AKM-së në përgaditjen dhe mbrojtjen e PTK-së për konkurrencë. Kështu AKM ka dështuar vazhdimisht që të parandalojë pjestarë të menaxhmentit të PTK-së të shkelin kontratat. Një pjesë e menaxhmentit të PTK-së kanë thyer kontratat me PTK-në duke u transferuar thjesht tek kompania konkurreuese Ipko. Saknsionimi i një periudhe kohore të caktuar në kontratë brenda së cilës një zyrtar nuk mund të kalojë me punë tek konkurrenti ka për qëllim mbrojtjen e kompanisë nga disa rreziqe. Shkelja e këtij rregulli ka bartur me vete tri rreziqe të mëdha dhe dëmi në këto kuptime tashmë është shkaktuar:

- Me kalimin e thjesht tek kompania konkurrense para së gjithash ekziston rreziku i bartjes së sekretit komercial. Sekretit komercial tashmë është e sigurt se është bartur nga PTK në Ipko duke qenë se ish-zyrtarë të lartë të PTK-së tashmë janë zyrtar të IPKO Telecommunication
- Ekziston një rrezik real i bartjes së ndikimit mbrapa në PTK nga ish-menaxherët e saj. Jo vetëm se një pjesë e menaxhmentit të PTK-së ka kaluar në kompaninë konkurrense, por ata vazhdojnë të kenë marrëdhënie të ngushta me menaxherë të Valës dhe është e qartë se në Kosovë biznesi privat i ka duart e lira për blerjen e vendimeve dhe politikave duke qenë se në Kosovë legjislativi që mbron kompanitë publike nga konkurrenca jolohale dhe nga ndikimet korruptive të sektorit privat nuk është shumë i zhvilluar

- Me mundësinë e transferit të thjesht tek konkurrenti hapet rruga që operatori privat thjesht të blejë menaxhmentin e operatorit publik qoftë për t'i kaluar ata me punë në Ipko, qoftë për të dhënë dorëheqje dhe për të shkaktuar zbrazëti në "know how" tek konkurrenti.

Këto janë vetëm disa nga aspektet të ndikimeve që tashmë janë të dukshme dhe që AKM për shkak se në Bordin e saj përfaqëson konflikt interesi nuk ka pasur vullnet për t'i parandaluar. Tashmë ka pasur indikator për pasojat që PTK është duke paguar për shkak të rrethanave që u cekën më lart.

Momenti më ilustrues i ushtrimit të ndikimit politik ka qenë me rastin e vendimit të ish-Bordit të PTK-së për lirimin e tarifave në telefoninë mobile Vala. Para rreth dy javësh që riaktualizuar mundësia e implementimit të vendimit për lirimin e tarifave për konsumatorët me parapagim të Valës. Ky librim është ngrirë dhe implementimi i tij nuk ndodhi para se Ipko të dalë me një eveniment të madh publik për librim tarifash. Zyrtarë të lartë të Ipkos kanë qenë në kontakte të rregullta me menaxherë të Valës gjatë tërë kësaj kohe sa është shtyrë nxjerrja e lajmit për lirimin e tarifave në Valas. Disa ditë më vonë, në një profil krejtësisht të ulët, me disa rreshta njoftohet shtypi se Vala ka libruar tarifën. Në ndërkohë, në një thyerje të etikës, Ipko ka performuar shkëlqyeshëm në bërjen publike të librimin të tarifave. Kjo u bë me qëllim që Ipko të ketë ekskluzivitetin për publikimin e librimin të tarifave e para dhe që të ketë një boom publik më të madh sesa Vala, e cila adaptoi një profil marketingu gati të pavrejtshëm të prezantimit të librimin. Arsyetimi publik pse nuk është implementuar librimi i tarifave të Valas deri pas daljes së Ipkos me librim edhe pse vendimi është marrë më herët ka qenë krejtësisht teknik. Ky arsyetim mbase mund të qëndronte sikur menaxherët e Valas të sqaronin nëse u arrit dhe si u arrit evitimi i këtij problemi teknik, gjë që natyrisht nuk ndodhi fare. Në përgjithësi, përkundër faktit se ka mundësi të mjaftueshme finansiare, Vala pothuaj se nuk është duke iu përgjigjur agresivitetit të jashtëzakonshëm në marketing operatorit privat Ipkos.

Të gjitha këto ndodhin para hundës së partive politike, të cilat i kanë duart e lidhura duke qenë se, siç u pa në pjesën e parë të kësaj analize, gjatë procesit në një mënyrë ose në një tjetër është shtrirë ndikimi i të ashtuquajturit inters special në politikë që ka shtirë biznesi slloven në Kosovë jo vetëm në sektorin e telekomunikimit, por edhe në atë të tregut finansiar. Kjo është duke dëmtuar rëndë interesat e qytetarit të Kosovës duke qenë se politikanët kosovarë janë duke i ulur standardet e përgjithshme të tenderëve dhe të privatizimit me qëllim që t'i bëjnë ato më të kapërdishme për bizneset relativisht të vogëla sllovene në krahasim me magnatët ndërkombëtarë. Kur i shton kësaj faktin se tenderët korruptohen sepse gatishmëria e kompanive relativisht të vogëla për të korruptuar qeveritë është shumë më e madhe sesa ajo e gjigantëve ndërkombëtarë, siç është për shembull Vodaphone, shifet qartë pse se standardi i përgjithshëm i privatizimit dhe i tenderëve të mëdhenj publik ka rënë.

Në anën tjetër, ART-ja vazhdon të punojë në favor të interesave të njerëzve që në procesin e tenderimit të operatorit të dytë dyshohet ta kenë blerë pjesën më të rëndësishme të politikanëve kosovarë. Kjo shihet edhe në marrëveshjen që ART ka

nënshkruar me operatorin e telefonisë mobile sipas së cilës në Kosovë nuk do të ketë operator tjetër për së paku 3 vitet e ardhshme.

Të gjitha këto që u than më lart tregojnë një strategji tipike e dëmtimit të kompanisë publike për ta ulur vlerën e kompanisë publike deri në një madhësi të përballueshme me rastin e nxjerrjes në shitje për kompani të vogëla dhe anonime në tregun e telekomunikacionit duke rivendosur një monopol në favor të operatorit privat të telefonisë, i cili siç u argumentua më lart ka një ndikim të madh në politikë. Operatori publik Vala do të nxirret në shitje atëherë kur madhësia dhe vlera e tij të ketë rënë tepër shumë dhe kur dominimin në tregun e telefonisë publike t'ia ketë dorëzuar operatorit privat, me qëllimin që ky i fundit mos të rrezikohet nga çfarëdo konkurrence.

Rreziku i bartjes së këtij modeli në sektorët tjerë publik

Fatkeqësia me qeveritë kosovare nuk mbaron këtu. Një qasje e ngjashme me konflikte interesash e filluar nga qeveria e kaluar në sektorin energjetik dhe në disa sektore tjera është duke u thelluar më tutje nën mandatin e Thaçit. Qeveria e Kosovës, për çështjet më të rëndësishme, ka sjellë vendime që favorizojnë korrupsionin, dëmtimin e interesave publike në favor të interesave private e partiake, krijimin e ndikimeve politike nga biznesi që ndërtojnë një sistem oligarkik të dominuar nga magnatë të ndërtuar nga aktivitete të dyshimta ekonomike.

Sikur që u disiplinua PDK dhe mbyllli njërin sy për shkeljet skandaloze që ndodhën në tenderin për operatorin e dytë të telefonisë mobile, ngjashëm është disiplinuar edhe kundërshtimi i vazhdueshëm i kësaj partie ndaj privatizimit të Ferronikelit. Që prej momentit kur kryetarin të PDK-së, Hashim Thaçit, iu sigurua një vizitë në Izrael dhe prej atje sollli ca “konsulentë” për partinë e tij, PDK-ja u hesht për shkeljet që u bënë në procesin e privatizimit të Ferronikelit, ku pronarë është një konzorcium me izraelit. Këta “konsulentë” në një moment ose në një tjetër duket se kanë siguruar mbijetesën financiare të PDK-së dhe kjo u pa qartazi edhe në momentin kur Qeveria Thaçi emroi izraelitin Arie Rabfogel anëtar të Komitetit drejtues për projektin më të rëndësishëm që ka ndodhur ndonjëherë në Kosovë, atë të termocentralit Kosova C.

Sot, në lidhje me kompanitë publike vendosin njerëz që shprehin qartazi qëllimin për t'i dëmtuar dhe mbyllur ato. Sikur PTK-ja edhe KEK-u ka qenë shënjestër e njerëzve që kanë përfaqësuar interesa private në treg. Deri sot, njerëzit që kanë qenë anëtarë të forumeve që kanë udhëhequr me kompanitë publike ose janë shprehur haptazi se do të mbyllin kompanitë të cilave u prijnë, si në rastin e tregut të energjetikës, KEK-ut, ose kanë përfaqësuar interesa të konkurrentëve në treg duke e zvogëluar kompaninë publike dhe duke krijuar ambient për kompaninë private, siç është rasti PTK-së. AQB është sektori tjetër i rrezikuar nga ndikime të tilla duke qenë se edhe në këtë rast Qeveria ka favorizuar për drejtor një kandidat që ka pasur mbrapa dyshime të pasqaruara korrupsioni. Për përdorim politik të resurseve publike kjo Qeveri tashmë i ka përgaditur parakushtet edhe në Administratën Tatimore të Kosovës, por edhe në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, ku ka dërguar drejtorë politik.

Rekomandimet

Mënyra e vetme për të shpëtuar pronën publike është ndërtimi i një integriteti publik. Mundësitë janë shumë të kufizuara duke qenë se ekzekutivi, si institucioni që është i thirrur të mbrojë interesat e qytetarit tashmë ka treguar shenja të qarta se do të dëmtojë sektorin publik në favor të interesave partiake. Mënyra e vetme për të mbrojtur atë që ka ngelur në kompaninë e vetme publike në telekomunikim e shërbime interneti, PTK-në, është që Kuvendi i Kosovës të alarmohet dhe të krijojë një supervizim më strikt të punës së Qeverisë dhe të AKM-së. Mënyrë tjetër e evitimit të dëmtimit të mëtutjeshëm të PTK-së është përgaditja e saj për shitje, por jo në këto kushte aktuale kur ka filluar një erozion i aseteve të saja. Në shitje do duhej të nxirreshin jo më shumë se 49% të aksioneve të PTK-së duke qenë se kjo është një kompani me fitime të mëdha nga e cila Buxheti i Kosovës vetëm sa fiton. Duhet të sigurohet një integritet menaxhues, një prezervim dhe supervizim i rrept i aseteve të kësaj kompanie si kompania më e madhe publike që eventualisht do të ndihmojë Kosovën në kapërcimin e krizës ekonomike. Të bëhet një vlerësim i sakt dhe objektiv i vlerës së saj. Të sigurohet se mekanizmat që do ta përgadisin për privatizim nuk do të përfaqësojnë konflikt interesi dhe në këtë sens Bordi i AKM-së kërkon një trajtim special duke qenë se bart rreziqe të mëdha.